



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2026

VENDIM

Nr.9, datë 13.03.2026

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VKD NR. 33, DATË 22.12.2025 “PËR MIRATIMIN E
METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE PËRBËRËS TË PAGËS
BRUTO, VLERËS PËR SECILIN ELEMENT, SI DHE RREGULLAT, KRITERET,
MASËN E TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE DHE PËRFITIMET PËR
PUNONJËSIT E AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE (AKEP)””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Z.	Armer Juka	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 13 mars 2026 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues, të ndryshuar dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Për një ndryshim në VKD nr. 33, datë 22.12.2025 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e elementeve përbërës të pagës bruto, vlerës për secilin element, si dhe rregullat, kriteret, masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet për punonjësit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 6 e nenit 13 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,
2. Pika 6 e nenit 3 si dhe shkronja “dh” e nenit 6 të ligjit nr. 35, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.
3. VKD nr. 33, datë 22.12.2025 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e elementeve përbërës të pagës bruto, vlerës për secilin element, si dhe rregullat, kriteret, masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet për punonjësit e autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare (AKEP)”

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projektvendimi i arsyetuar;
2. Relacioni shpjegues i projektvendimit,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

1. Ligji nr. 54, datë 20.12.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, përcakton AKEP, si një autoritet rregullator të pavarur, me burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të përmbushur detyrat e ngarkuara me ligj.
2. Projektvendimi është hartuar në referencë të pikës 6, të nenit 13 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilës: *“Këshilli Drejtues i AKEP-it, ndër të tjera, miraton:*
 - a) *elementet përbërëse të pagës bruto mujore të të punësuarve të institucionit;*
 - b) *vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të institucionit;*
 - c) *rregullat, kriteret dhe masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet.*
3. Ligji nr. 35, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, përcakton në mënyrë të veçantë se autoritetet rregullatore të pavarura kanë kompetencë për rregullimin e brendshëm të trajtimeve financiare, në respekt të parimit të pavarësisë funksionale dhe administrative.
4. Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), është organi kompetent i cili miraton në mënyrë të pavarur elementët përbërës së pagës bruto, vlerën për secilin element, si dhe rregullat, kriteret, masën e trajtimeve dhe përfitimet e tjera financiare të punonjësve të tij.

5. Me vendim nr. 33, datë 22.12.2025, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar “Metodologjinë për përcaktimin e elementeve përbërës të pagës bruto, vlerës për secilin element, si dhe rregullat, kriteret, masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet për punonjësit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.
6. Në kategorinë e punonjësve të klasës V sipas metodologjisë janë klasifikuar pozicionet e punonjësve të shërbimit të përgjithshëm (mbështetës) të AKEP, për të cilët paga bazë është përcaktuar duke iu referuar trajtimit të këtyre pozicioneve në administratën publike, sipas VKM nr. 326, datë 31.05.2023, e ndryshuar.
7. Me VKM nr. 87, datë 06.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar”, paga bazë për këto pozicione rezulton të jetë rritur me 10,000 lekë/muaj, duke reflektuar kështu dhe rritjen e pagës minimale në shkallë vendi nga 40,000 lekë në 50,000 lekë.
8. Duke qenë se AKEP, si autoritet rregullator i pavarur, nuk i nënshtrohet drejtpërdrejt akteve të Këshillit të Ministrave në fushën e përcaktimit të pagave, por ushtron kompetencën e tij rregullatore përmes vendimmarrjes së Këshillit Drejtues, propozohet referimi i standardit të përcaktuar nga VKM nr. 87/2026 si kriter orientues për harmonizimin e pagës bazë të punonjësve mbështetës.
9. Gjithashtu me miratimin e VKM nr. 131, datë 27.02.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, është miratuar rritja e pagës bazë të punonjësve të administratës me 2.5%, si rezultat i politikave të indeksimit të pagave.

Në këto kushte, AKEP arrin në përfundimin që bazuar në pikën 3, të nenit 7 të VKD nr. 33/2025, që përcakton se: *“rritja e pagës bazë mund të bëhet në rastet kura. kërkohet indeksim sipas inflacionit”*, e njëjta normë rritjeje të aplikohet edhe për punonjësit e AKEP, të përfshirë në klasat 1,2,3,4, të Aneksit 1, të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14 dhe pikën 1 të nenit 15, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në Aneksin 1, të VKD me nr. 33, datë 22.12.2025 “Për miratimin e Metodologjisë “Për përcaktimin e elementëve përbërës së pagës bruto, vlerës për secilin element, si dhe rregullat, kriteret, masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet për punonjësit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare””, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1 janar 2026.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Armer Juka	Bleron Dokle	Edlira Dvorani	Lorenc Bako

ANEKSI 1 - PAGA DHE SHITESA SIPAS NIVELEVE, KLASAVE DHE GRUPEVE

NIVELI		KLASA	GRUPI	Masa e pagës bazë (në lekë)
I	I parë i drejtimit	I	A	210,125
			B	184,500
II	I dytë i drejtimit	II	A	158,875
III	I tretë i drejtimit	III	A	119,000
			B	
IV	I katërt (Shërbim profesional)	IV	A	95,000
			B	85,000
V	I pestë (Shërbim i përgjithshëm)	V	A	51,800
			B	52,500
			C	50,000